

Tabloidi gjerman, Bild, në një shkrim të sajën mbi Ramazanin, rëndit pesë këshilla për jo-agjëruesit ndaj agjëruesve.

Sipas saj, nëse punon në zyrë me një të agjërueshëm duhet ta kuptoni nëse ai vonohet gjatë faljes së namazit ose edhe nëse humbet koncentrimi gjatë perëndimit të Diellit.

Më poshtë i keni të renditura këshillat.

?Gjatë kohës së agjërit, mundohuni ti evitoni hajet dhe pijet përpara kolegëve tuaj myslimanë. Veçanërisht pijet alkoolike.

? Edhe falja e namazit i përket Ramazanit. I mirëkuptoni kolegët tuaj nëse ata vonohet pak më tepër gjatë këtij muaji.

? Sivjet orët e agjërit janë shumë të gjata. Andaj keni respektin dhe kuptojeni kolegun tuaj, nëse ai gjatë ditës nuk ka koncentrimin e duhur për të punuar.

?Ramazani është muaji i shpirtit dhe faljes së mëkateve. Evitoni sharjet dhe shakatë e tepërta në zyrë.

? Në fund të muajit, mund t'ia uroni kolegut tuaj mysliman, "Urime Bajramin". /mapo.al/